



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 853, datë 29.12.2021

P Ë R

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.307, DATË 16.4.2020,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT  
TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT  
DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE  
NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR",  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:
  - a) Në pikën 3.1, shifra "... 1 831 788 178 (një miliard e tetëqind e tridhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH..." zëvendësohet me "... 1 931 788 178 (një miliard e nëntëqind e tridhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH...";
  - b) Në pikën 3.1/a, shifra "... 1 177 622 177 (një miliard e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH..." zëvendësohet me "... 1 277 622 177 (një miliard e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH...".

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN  
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE

**ARBEN AHMETAJ**

NR.PROT. 6547/1  
DATE 30.12.2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I  
I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E  
REFORMAVE  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

